

KËRKESË
Nr. 4635/7, datë 31.10.2016
PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve të Brendshme shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Sistemim dhe asfaltim i Rrugës së Gazit Divjakë”.

Subjekti kërkues është Bashkia e Divjakës. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë, pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim.

Vlera totale e shpronësimit është 10 920 (dhjetë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Elona Gjebrea

LISTA EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË
“SISTEMIM DHE ASFALTIM TË RRUGËS SË GAZIT DIVJAKË”

Nr.	Emri mbiemri	Nr. i pasurisë	Zona kadastrale	Sipërfaqja m ² /tokë arë	Çmimi në lek/m ²	Vlera në lekë	Lloji i dokumentit të pronësisë
1	Lavderim Muharrem Xheja	703/12	1492	30	364	10 920	Konfirmim nga ZRPP-ja
	Totali					10 920	